



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Rev.nr.165/2024

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Mr.sc. Muhamet Rexha, kryetar, Nenad Laziq dhe Milena Gjeriq anëtarë, në çështjen juridike të paditëses Sh. B.i –I. nga P., të cilin e përfaqëson Av. Gazmend Sopa nga L., kundër të paditurës Shërbimi Spitalor dhe Klinik Universitar i Kosovës (SHSKUK) – QKUK, me seli në P., për shkak të kompensimit të pagës së 13-të, duke vendosur sipas revizionit të paditëses, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.5223/23 dt.20.12.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me 18.04.2024, mori këtë,

A K T V E N D I M

HEDHET poshtë si i palejuar revizioni i paditëses, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Ac.nr.5223/23 datë 20.12.2023.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës Ac.nr.5223/2023 dt.20.12.2023, aprovohet si e themeltë ankesa e të paditurës, ndryshohet aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë, C.nr.4952/21 dt.20.03.2023 dhe gjykohet si në vijim: Refuzohet si e pa themeltë kërkesëpadia e paditëses Sh.e B. – I. nga P., me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura, që paditëses t’ia kompensojë në emër të pagës së 13-të, për vitet 2018, 2019 dhe 2020, shumën prej $3 \times 377,00 = 1,131,00$ euro, me kamatë prej 8%, e cila do të llogaritet nga marrja e aktgjykimit e deri në pagesën definitive, në afatin prej 7 ditësh, nën kërcënimin e përmbarimit të detyrueshëm.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë paditësja ka paraqitur revizion për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që, siç thuhet në të, të priset aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë dhe çështja ti kthehet në rigjykim Gjykatës së Apelit të Kosovës, ose aktgjykimi i goditur të ndryshohet dhe kërkesëpatria e paditëses të miratohet si e bazuar si dhe të detyrohet e paditura që paditëses të ia kompensojë edhe shpenzimet e procedurës.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktgjykimit të goditur dhe të lejueshmërisë së paraqitjes së revizionit, si dhe shkresave të lëndës, sipas nenit 218 par.2 pika d) të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjeti se:

Revizioni i paditëses është i palejuar.

Me dispozitën e nenit 211.2 të Ligjit për Procedurën Kontestimore përcaktohet se: ”Revizioni nuk lejohet në kontestet pasurore juridike në të cilat kërkesëpatria ka të bëjë me kërkesat në të holla, me dorëzimin e sendit ose me përmbushjen e ndonjë premtimi tjetër, po qe se vlera e objektit të kontestit në pjesën e goditur të aktgjykimit nuk i kalon 3.000-euro”. Sipas kësaj dispozite ligjore rrjedh se, në rastin konkret, e duke qenë se vlera e objektit të kontestit në pjesën e goditur të aktgjykimit është 1,131.00 euro, d.m.th. nuk kalon mbi 3.000-euro, revizioni nuk është i lejuar.

Pasi që gjykata e instancës më të ulët nuk ka vepruar në pajtim me nenin 218.1 dhe 2 pika d) të LPK, që të hedh revizionin si të palejuar, Gjykata Supreme e Kosovës, me zbatimin e nenit 221 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, u dashtë që të njëjtin ta hedh si të palejuar.

Në mbështetje të dispozitës së nenit 221 lidhur me nenin 218 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS-PRISHTINË

Rev.nr.165/2024 datë 18.04. 2024

Kryetari kolegjit

Mr.Sc.Muhamet Rexha